

KOMUNA E RE E ZGJIDH PROBLEMIN E MENAXHIMIT  
TË MBETURINAVE

## Zvicra e pajis çdo shtëpi të Hanit të Elezit me shporta bërlloku

HANI ELEZIT, 14 TETOR - Komuna e re e Hanit të Elezit e ka zgjidhur problemin e menaxhimit të mbeturinave. Projekti për qeverisje lokale dhe decentralizim LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane, e ka financuar projektin për pajisjen e çdo shtëpie në Han të Elezit me shporta mbeturinash. "Për blerjen e këtyre kontejnerëve LOGOS-i i ka investuar rreth 40 mijë euro, ndërsa Komuna ka participuar me rreth 7 mijë euro", ka theksuar Bashkim Sopu, zëdhënës i Komunës të Hanit të Elezit, të dielën. Ndërkaq Rufat Shkreta, drejtor i Shërbimeve Publike, ka thënë se procesi i shpërndarjes së kontejnerëve të vegjël për çdo familje hanelezase është përmbyllur javën e kaluar. "Ka mbetur të vendosen në qytet edhe 32 kontejn-

erë të mëdhenj në afërsi të shkollave dhe institucioneve të tjera", ka thënë ai. Drejtori Shkreta ka rikujtuar se pajisja e qytetarëve me kontejnerë është bërë e mundur pas vendimit të LOGOS-it për ta mbështetur financiarisht planin e hartuar nga Komuna për menaxhimin e mbeturinave. "Pas marrjes së kontejnerëve, kryefamiljarët e familjeve përfituese i kanë nënshkruar kontratat të cilat i obligojnë ata që të paguajnë 3 euro në muaj për largimin e bërllokut", ka theksuar Shkreta. Sipas tij, bizneset pritet të ngarkohen me pagesë mujore prej 9 eurosh për shërbimet që do t'ua kryejë kompania e kontraktuar për largimin e bërllokut nga kontejnerët.

Ekrem Raka

KOHA DITORE  
15.10.2012